



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me kandidatët për ambasadorë të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë, rezident dhe jorezident, në përfaqësitë tona diplomatike respektivisht në Republikën e Çekisë, në Republikën Federative të Brazilit; në Republikën e Kroacisë, në Bosnjë- Hercegovinë; në Mbretërinë e Suedisë, në Republikën e Finlandës, Republikën e Islandës dhe Mbretërinë e Norvegjisë.

2. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Andrea Marto, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Klajda Gjoshaj, Ervin Bushati, Xhemal Qefalia, Edmond Panariti, Evis Kushi, Tritan Shehu dhe Klevis Balliu.

Mungojnë:

Nard Ndoka, Rudina Hajdari, Eglantina Gjermani, Edi Paloka dhe Vasilika Hysi

Të ftuar:

Gazmend Barbullushi – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë

Ilirian Kuka – kandidat për ambasador

Rezar Bregu – kandidat për ambasador

Riza Poda – kandidat për ambasador

Virgjl Kule – kandidat për ambasador

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë seancën dëgjimore, sipas rendit të ditës, ku të ftuar kemi kandidatët për ambasadorë, të cilët shoqërohen nga zoti Barbullushi, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë.

Në seancë dëgjimore janë paraqitur zotërinjtë Ilirian Kuka, Rezar Bregu, Riza Poda, si dhe zoti Virgjil Kule.

Faleminderit, zotërinj, që keni ardhur!

Fjala është për ju, zoti Barbullushi.

Gazmend Barbullushi – Faleminderit, e nderuara zonja kryetare!

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që, në emër të Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë, të prezantoj para jush katër kandidatët për ambasadorë, zotërinjtë: Ilirian Kuka, Rezar Bregu, Riza Poda dhe Virgjil Kule.

Zoti Ilirian Kuka propozohet të jetë ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë në Republikën e Çekisë. Ai ka mbaruar studimet e larta në degën “inxhinieri elektronike” në Tiranë dhe në Bari, ku ndërthur eksperiencën praktike mjaft të suksesshme në fushën e biznesit në atë të drejtimit menaxherial të nivelit të lartë. Në vitet 2005-2007 ka qenë drejtor i Përgjithshëm i Albtelekomit. Është angazhuar aktivisht në diplomaci dhe prej vitit 2014 ka shërbyer dhe shërben si këshilltar për çështjet e ekonomisë në ambasadën tonë në Pragë.

Marrëdhëniet me republikën çeke kanë njohur rritje të vazhdueshme. I konsiderojmë të jenë në nivelin e tyre më të lartë në dekada. Shkëmbimet politike kanë vijuar të jenë intensive, pavarësisht rrjedhave të ditës në politikën e brendshme çeke, duke krijuar kështu premisa të mira për zgjerimin e bashkëpunimeve në fusha të tjera. Praga është mbështetëse e palëkundur e integritit europian të Shqipërisë, e cila zgjerimin e Bashkimit Europian me vendet e Ballkanit Perëndimor e sheh si kontribut thelbësor në sigurinë e kontinentit.

Në dëshirën tonë është që sektori ekonomik me republikën çeke të gjallërohet edhe më tej, duke përfutur nga rezultatet e mira të deritanishme të shënuara dhe nga niveli shumë i mirë i marrëdhënieve politike.

Kandidati i propozuar, zoti Ilirian Kuka, është njohës i mirë i politikës dhe shoqërisë çeke, çka besojmë se do të luajë rolin që pritet prej tij për thellimin e mëtejshëm të shkëmbimeve, me në fokus ato ekonomike dhe promovimin e mëtejshëm të turizmit.

Zoti Rezar Bregu është propozuar të jetë ambasadori ynë i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë në Republikën Federative të Brazilit. Është anëtar i shërbimit të jashtëm që në vitin 1995 dhe mban gradën personale “Ministër fuqiplotë”. Ai ka shërbyer në disa pozicione me rëndësi në aparatin e ministrisë dhe në përfaqësi. Në vitet 2007-2012 ka qenë ambasador në Buenos Aires (Argjentinë), rezident, si dhe në disa vende të tjera të rajonit, jorezident.

Zoti Rezar Bregu është njohës i mirë i Brazilit dhe i hapësirës së atjeshme, si dhe flet disa gjuhë të huaja.

Brazili është faktor global aktiv dhe për këtë arsye përfaqësimin tonë në këtë vend e vlerësojmë të veçantë. Niveli i marrëdhënieve është shumë i mirë dhe prania e ambasadës sonë atje (e kemi hapur në vitin 2009) ka ndihmuar për zgjerimin e kontakteve, ku edhe Brazili ka reciprokuar me vendosjen e një ambasade në Tiranë. Është vendi i parë latinoamerikan që vendos ambasadë në Tiranë. Jemi të interesuar, pavarësisht nga distanca të largëta, për çuarjen më tej të dialogut politik, si dhe punësimin e bashkëpunimin.

Tregu brazilian renditet, për nga madhësia, një vend i madh në botë. Primare për ambasadorin tonë atje do të jetë pa dyshim rritja e volumit të shkëmbimeve ekonomike. Brasilia është e vetmja ambasadë që kemi në atë hapësirë. Ajo, përveçse si kanal komunikimi me një numër të madh vendesh të vetë kontinentit, detyrë e posaçme e ambasadorit tonë atje do të mbetet përkujdesja për diasporën jo vetëm në Brazil, por edhe në vendet e tjera në rajon.

Zoti Riza Poda paraqitet para komisionit të nderuar si kandidat për ambasador në Republikën e Kroacisë. Ka kryer shkollën e lartë për gjuhë e letërsi angleze, si dhe drejtësi. Në vitin 2011 është emëruar konsull i Përgjithshëm në Selanik, ndërsa në vitin 2014 i është besuar dhe ka kryer me sukses detyrën e ambasadorit në republikën çeke në Pragë.

Me Kroacinë, si vend anëtar i NATO-s dhe i Bashkimit European, kemi një bashkëpunim të shkëlqyer politik në të gjitha dimensionet. Ky kontekst duhet të materializohet edhe më mirë në shkëmbime biznesi, tregtare dhe në investimet e ndërsjella. Në vëmendjen konstante të ambasadorit do të jetë diaspora jonë atje.

Zoti Virgjl Kule propozohet ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë në Mbretërinë e Suedisë. Zoti Kule është një personalitet i mirënjohur për publikun, vjen nga fusha e gazetarisë, medieive radiotelevizive, është studiues dhe autor i disa punimeve shkencore historiografike, si dhe njohës i thelluar i teknikave të komunikimit ndërkulturor. Ai flet disa gjuhë të huaja.

Me Suedinë kemi marrëdhënie shumë të mira. Si vend anëtar dhe me peshë brenda Unionit, Suedia i ka dhënë mbështetje të vazhdueshme Shqipërisë për integrimin evropian. Jemi të interesuar që ritmet dhe intensiteti i dialogut politik të kurohen dhe të intensifikohen edhe më tej.

Diplomacia parlamentare do të duhet të jetë në fokus të veçantë, si dhe duhet t'i kushtohet vëmendje e vazhdueshme përkujdesjes dhe problematikës së emigracionit tonë në Suedi dhe në rajon.

Pritshmëria jonë përkundrejt ambasadorit ka të bëjë edhe me rezultate konkrete në tërheqjen e investimeve domethënëse në sektorët strategjikë të vendit. Në të njëjtën kohë promovimi i mundësive për turizëm në Shqipëri përbën një provë të mirëfilltë edhe për të.

Zonja kryetare e komisionit,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për vëmendjen tuaj në këtë prezantim të shkurtër të kandidatëve tanë për ambasadorë!

Ne besojmë se ata i plotësojnë më së miri kriteret për të na përfaqësuar në vendet përkatëse si për nga eksperiencia, ashtu edhe nga personaliteti e përkushtimi që kanë treguar në detyrat që kanë mbajtur në rrugëtimin e tyre profesional.

Mbetem në dispozicionin tuaj për informacione dhe pyetje të tjera.

Kandidatët për ambasadorë janë prezentë dhe, po ashtu, në dispozicionin tuaj për të paraqitur objektivat dhe idetë e tyre konkrete në përmbushjen e detyrave që do t'u dalin, natyrisht në qoftë se ju do t'u jepni besimin tuaj.

Mimi Kodheli – Ju faleminderit, zoti Barbullushi!

Nuk e di nëse rendi i paraqitjes së zotërinjve kandidatë për ambasadorë është përcaktuar rastësisht.

Gazmend Barbullushi - Rend alfabetik.

Mimi Kodheli – Dakord.

Mirë se vini!

Meqenëse është rend alfabetik, unë do ta filloja nga një njohje e vjetër personale imja me zotin Kule (besoj se kaq më lejohet si drejtuese e këtij komisioni), për të cilin ndaj personalisht një respekt të veçantë, për arsye se në korridorin ku zoti Kule ka filluar të punojë, unë kam kaluar shumë vite më parë, si fëmija i dikujt tjetër, që punonte në ato ambiente.

Fjala për ju, zoti Kule!

Virgil Kule – E nderuar zonja kryetare e komisionit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj anëtarë të komisionit,

Me një ndjenjë të lartë përgjegjësie jam para jush sot, për të paraqitur disa nga objektivat e punës sime dhe të personelit diplomatik, që do të vijojë të kryejë detyrën fisnike të përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Suedisë, në Republikën e Finlandës dhe Mbretërinë e Norvegjisë, (jorezident)

Unë, natyrisht, brenda një kohe relativisht të shkurtër kam studiuar dosjet përkatëse të marrëdhënieve politike midis vendit tonë dhe secilit prej këtyre 3 vendeve skandinave. Kam konstatuar se në përgjithësi ka pasur një ecuri konstante, me kahje pozitive, si në marrëdhëniet bilaterale, ashtu edhe në marrëdhëniet që përfshijnë dimensione rajonale, pra midis vendeve skandinave dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor. Marrëdhëniet politike konsiderohen si shumë të mira zyrtarisht. Ky definicion, përveçse një vlerësim i lartë për punën e paraardhësve të kësaj përfaqësie diplomatike, përbën për mua edhe një sfidë intelektuale dhe profesionale për të punuar fort, që marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe këtyre vendeve të njohin një nivel akoma më të lartë. Si Suedia, ashtu edhe Finlanda, kanë demonstruar një vullnet të mirë politik për të përkrahur përpjekjet e Shqipërisë që nëpërmjet kryerjes së reformave të domosdoshme, të fillojë negociatat për pranimin në BE. Kjo reflektohet edhe në diskutimet e kohëve të fundit, kur ato u renditën në favor të çeljes së negociatave. Sigurisht, ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i trendit pozitiv të këtyre vendeve skandinave në favor të integritetit të Shqipërisë, do të jetë prioritet absolut në punën e përfaqësisë sonë diplomatike. Dikur Suedia, Norvegjia dhe Finlanda konsideroheshin si zona relativisht të largëta në raport me interesat imediate të Shqipërisë, por përfshirja e tyre në programet për zhvillim dhe inkurajimi i tyre politik në dobi të paqes dhe bashkëpunimit me vendet e Ballkanit Perëndimor, na bëjnë të kuptojmë se distancat e kanë humbur kuptimin e dikurshëm dhe se ato, nuk e kushtëzojnë aspak mënyrën dhe intensitetin e bashkëpunimit politik, ekonomik dhe kulturor. Sot përbërësit kryesorë për përmirësimin e marrëdhënieve janë identifikimi i interesave të përbashkëta në çdo fushë dhe cekja e tyre metodike dhe dinamike. Ndaj, ato do të jenë objektivat prioritare për punën e ekipit tonë. Ne do të punojmë që bashkëpunimi politik të vazhdojë të intensifikohet edhe në aspektin e politikës globale. Shqipëria dha mbështetjen e saj për kandidaturën suedeze, si anëtare e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Këto ditë, Suedia mori edhe kryesimin me rotacion të këtij këshilli, duke afirmuar edhe një herë ADN-në e diplomacisë suedeze, ligjin dhe rregullat ndërkombëtare në favor të

paqes dhe sigurisë, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe perspektivave të reja drejt paqes dhe zhvillimit për të evituar krizat humanitare.

Është me rëndësi që gjatë punës sonë të kryejmë vëzhgime dhe të nxjerrim konkluzione, lidhur me rolin e rëndësishëm të Suedisë në Europë dhe në botë. Ky shtet e ka rritur progresivisht reputacionin e vet. Brenda një periudhe 10-vjeçare, nga vendi i shtatëmbëdhjetë, Suedia u radhit vjet në vendin e parë për lehtësinë e të bërit biznes. Ai konsiderohet, si një vend globalist kompetitiv, ku zë vendin e gjashtë në botë.

Dallohet për barazinë gjinore të shkallës së lartë dhe për korrupsion fare të ulët. Bashkë me Finlandën, Gjermaninë, Holandën e Danimarkën, Suedia quhet vend lider i inovacionit. Sistemet arsimore të Suedisë dhe të Finlandës janë më të përparuarat në botë. Njohja dhe madhësia e mekanizmave që janë vënë në lëvizje nga *think tank*-u suedez për këto arritje spektakolare, përbën padyshim një burim për pasurimin e *knoë hoë*-it për administrimin e shtetit dhe të ekonomisë. Janë praktika pozitive prej të cilave mëson e gjithë bota, ndaj aq më shumë duhet të mësojmë ne.

Pa u thelluar edhe në të tilla angazhime, ne nuk e quajmë të justifikuar prezencën tonë në atë vend. Ambasada e Suedisë mbulon edhe Republikën e Finlandës, edhe Mbretërinë e Norvegjisë, por këto vende kanë secila specifikat e tyre të qasjes. Midis tyre ka edhe ndryshime të mëdha në të gjitha aspektet, për të mos folur në specifikat e qasjes së tyre ndaj BE-së dhe NATO-s. Për shembull, Norvegjia nuk është anëtare e BE-së, por është anëtare e NATO-s. Suedia dhe Finlanda janë anëtare të BE-së, por nuk janë anëtare të NATO-s, ndonëse me këtë të fundit Suedia ka marrëveshje partneriteti, kurse Finlanda ka bashkëpunim mbi bazat e mosangazhimit ushtarak (kuptohet për shkak të pozicionit të tyre gjeografik në kufi me Rusinë).

Në kuadër të politikës globale ne duhet të punojmë që të shprehet qartë dhe në kohën e duhur kujdesi i politikës shqiptare ndaj ndjeshmërive politike përkatëse të Suedisë, Finlandës dhe Norvegjisë në raport me pozicionin e tyre gjeografik dhe gjeopolitik.

Në marrëdhëniet me Suedinë dhe Finlandën, si vende anëtare të BE-së, ne duhet të përdorim me lartësinë e pozicionit më të apdejtuar të mundshëm të Shqipërisë në kuadër të proceseve integruese të saj në BE. Çdo vit sjell gjëra të reja. Ne kemi një datë tashmë, qershor 2019, kur do të qartësohet përfundimisht çështja e negociatave. Megjithatë, siç është njoftuar, në korrik puna përgatitore do të fillojë nga ana jonë. Rrjedhimisht, asistenca suedeze në vazhdim për plotësimin e kapitujve specifikë të negociatave, që kanë të bëjnë me forcimin e shtetit ligjor, barazinë gjinore, respektimin e të drejtave të njeriut etj., duhet t'u përshtatet

nevojave tona konkrete, të cilat në kohën dhe në momentin e përshtatshëm duhet të identifikohen dhe t'u paraqiten institucioneve përkatëse të këtij shteti. Nëpërmjet këtij procesi forcohet edhe më tej bashkëpunimi institucional me synim konsolidimin e avokatisë së Suedisë në favor të pranimit të Shqipërisë në BE. Jemi të ndërgjegjshëm se Suedia është ndër shtetet më ekzigjente dhe rigoroze. Ndaj në rajon do të punohet për shpejtësi, saktësi dhe qartësi thelbësore në informimin reciprok. Përveç kësaj, do të bëjmë përpjekje për të informuar edhe për mënyrën e harmonizimit të çështjeve specifike, për të cilat tranziston Suedia në kuadrin e përgjithshëm të plotësimit të kushteve për çeljen e negociatave, sikundër janë reforma zgjedhore, reforma në drejtësi e të tjerë. Pra, flitet për një informim kompleks të argumentuar dhe të besueshëm. Rezultatet e deritanishme në mbështetjen që i ka dhënë Suedia zhvillimit social dhe ekonomik të Shqipërisë në fushën e reformës administrative territoriale dhe në drejtimit kryesorë që janë përcaktuar në strategjinë suedeze për zhvillim dhe bashkëpunim me Shqipërinë 2014-2020, janë: nxitja e integritit ekonomik me BE-në, zhvillimi i ekonomisë së tregut, forcimi i shtetit ligjor, respektimi rigoroz i të drejtave të njeriut, barazia gjinore dhe mbrojtja e mjedisit, të cilat përbëjnë një bazë të mirë me mundësi për intensifikim të mëtejshëm në të ardhmen.

Me impakt të veçantë ka qenë programi për forcimin e policive në komunitet dhe marrëveshja për shkëmbimin e informacionit për çështjet e imigracionit dhe të azilit. Me kalimin e kohës është aktivizuar dukshëm bashkëpunimi me homologët suedeze për shkëmbimin e informacioneve policore nëpërmjet kanaleve të Interpolit dhe Europolit për hetimin e veprave penale në fushën e narkotrafikut, krimit ekonomik-financiar, pastrimit të parave, krimit kompjuterik e të tjerë. Gjithashtu, janë zhvilluar hetime paralele dhe operacione të përbashkëta në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike. Vazhdimi i programit për forcimin e policive në komunitet dhe të gjitha elementet e tij përbërës, që synojnë kapjen e standardeve europiane në këtë fushë, do të jenë pa dyshim objekt vëmendje e posaçme e punës sonë si përfaqësi dipolomatike. Po kështu do të jetë edhe sigurimi i mbështetjes së mëtejshme suedeze për zhvillim e kapaciteteve të emergjencave civile në Shqipëri.

Në fushën e mbrojtjes, bashkëpunimi i deritanishëm me projektet për eliminimin e minave antipersonel dhe asgjësimin e kimikateve mund të konkretizohet në një marrëveshje të posaçme, ende të munguar midis dy vendeve. Sigurisht, nevoja ose jo dhe kriteret propozuese për këtë marrëveshje do të diskutohen imtësisht me Ministrinë tonë të Mbrojtjes, duke pasur parasysh partneritetin e Suedisë me NATO-n.

Është për t'u theksuar se nivelet shumë të mira të marrëdhënieve politike nuk i përgjigjen aq sa duhet nivelit të bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar. Ndonëse ka pasur një rritje prej 49%, në krahasim me vitin 2015, volumi i shkëmbimeve tregtare me Suedinë nuk i kalonte 20 milionë euro. Edhe numri i bizneseve të vendeve nordike që operojnë në Shqipëri është relativisht i ulët, 15% për Suedinë dhe 6% për Finlandën. Bën dallim Norvegjia, e cila ishte angazhuar në projekte të rëndësishme në fushën e energjisë, por kapacitetet janë të mëdha edhe për fusha të tjera, sidomos në biznesin privat.

Mbetet sfidë kryesore për punën tonë gjetja e rrugës për një balancim sa më të drejtë të raporteve politike shumë të mira dhe marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare.

Diplomacia ekonomike do të jetë një prioritet tjetër i ekipit tonë. Ajo do të vihet në jetë mbi bazën e një programi të detajuar të hartuar nga ministrinë përkatëse dhe dhomat e tregtisë për të shpalosur para bizneseve skandinave në kohë reale të gjithë hapat që hedhë Shqipëria në fushën e legjislacionit dhe lehtësimit të të bërit biznes.

Kohët e fundit spikat interesi i shtuar i vendeve nordike për turizmin në Shqipëri. Këtu fshihen potenciale të mëdha, që ekipi ynë do t'i studiojë me prioritet të veçantë për të evidentuar jo vetëm shifra turistësh, por edhe problematikat që dalin në kuadrin e zhvillimit të kësaj industrie shumë të rëndësishme për vendin tonë. Turizmi nuk është vetëm industri, është njohje reciproke nga afër, shkëmbim vlerash dhe investigim potencialesh të pashfrytëzuara. Ndaj, për sa i takon punës konkrete afatshkurtër, synimi ynë do të jetë paraqitja sa më intensive dhe ekstensive e potencialeve turistike të Shqipërisë për të shtuar fluksin turistik në vendet skandinave dhe për këtë do të hartojmë një program të posaçëm veprimtarish.

Me këtë paraqitje të shkurtër, të ndërtuar mbi bazën e studimit të dosjeve përkatëse të marrëdhënieve të vendit tonë me shtete nordike, vihet re se ka ende një lloj plogështie nga ana jonë për sa i takon insistimit për të ngjallur interes në institucionet dhe segmentet e caktuara të shoqërisë suedeze për horizonte të reja bashkëpunimi.

Mendoj se marrëdhënieve ekonomike u mungon limfa e mjaftueshme menaxheriale dhe kulturore, që gjallëron bashkëpunimin e ndërsjellë.

Programet e zhvillimit rajonal, që ndërmarrin këto vende, nga të cilat përfiton jo pak Shqipëria, nuk janë të mjaftueshme për të promovuar në shkallën e duhur marrëdhëniet bilaterale të orientuara nga shkëmbimet në biznes.

Ne angazhohemi të punojmë më intensivisht, në mënyrë që në shekullin e komunikimit potencialet e Shqipërisë të njihen më në detaje në Suedi, në Norvegji dhe në Finlandë dhe bashkëpunimi të njohë nivele të reja më të larta.

Nxitja e takimeve më të shpeshta bilaterale në nivel shtetëror, parlamentar dhe qeveritar do të jetë një nga objektivat kryesore të punës tonë, me synimin jo vetëm të forcojë marrëdhëniet politike, por edhe të krijojë një empati më të madhe ndaj përpjekjeve të Shqipërisë për përparim dhe modernizim.

Një rëndësi të veçantë në këtë drejtim kanë edhe shkëmbimet kulturore. Fatkeqësisht, ende nuk kemi një marrëveshje ndërshtetërore në fushën e kulturës, shkencës, arsimit dhe rinisë, por gjasat janë që kjo gjendje të ndryshojë.

Më ka bërë përshtypje fakti se selia e ambasadës suedeze në Tiranë ndodhet në një mjedis studentor, zgjedhje kjo e vetë personelit, i cili deklaroi në ëbsite-n e ambasadës se kjo vendvendosje na shërben për të shfrytëzuar mundësitë për dialog me të rinjtë. Ky është një sinjal sa i thjeshtë, aq edhe i qartë i vëmendjes së diplomacisë suedeze ndaj brezit të ri të Shqipërisë, i cili meriton të ketë standarde më të larta arsimimi dhe kulturimi, ku pak më parë përmenda cilësinë e lartë të arsimit në Suedi. Një arsytim i thjeshtë na nxiti që kësaj vëmendjeje të palës suedeze t'i përgjigjet edhe pala jonë, duke u orientuar me mundësitë që ka shteti suedez për të rritur shkëmbimin midis të rinjve të të dyja vendeve. Natyrisht, hap i parë do të ishte përfundimi i një marrëveshjeje ndërshtetërore për bashkëpunim në fushën e shkencës, kulturës, arsimit dhe rinisë. Theksoj se për këtë çështje ekziston edhe një traditë, e cila duket se është lënë pas dore, e kam fjalën për marrëveshjen që përfshinte vitet, tashmë të largët, 1996, 1997 dhe 1998.

Nuk do të lë pa përmendur edhe angazhimin tonë të ardhshëm për të punuar me diasporën, duke identifikuar konfiguracionet e reja të krijuara atje dhe duke kontaktuar e mbajtur pranë sidomos të rinjtë e përgatitur në shkollat e thjeshta. Do të përpiqemi të gjejmë forma për t'i kompaktësuar ata në mbështetje të zhvillimit të vendit të tyre të origjinës. Në këtë drejtim mbetet për t'u hartuar një strategji e posaçme për përdorimin e rrjeteve sociale dhe mundësive të tjera që ofron bota virtuale.

Së fundi, kuptohet se edhe për shkak të vokacionit tim si njeri i medias, i punës humanitare në nivel ndërkombëtar, i publicistikës dhe studimeve historike do të ndikoj që të rritet mirëkuptimi dhe bashkëpunimi me qarqet përkatëse të shoqërive suedeze, norvegjeze dhe finlandeze në dobi të promovimit të vlerave shpirtërore dhe materiale të popullit tim europian.

Të nderuar anëtarë të komisionit, duke qenë i vetëdijshëm se detyra që më ofrohet mbart përgjegjësinë e madhe të përfaqësimit dinjitoz dhe në nivel të lartë profesional të Republikës së Shqipërisë në mbretëritë e Suedisë, të Norvegjisë dhe në Republikën e Finlandës shpreh përkushtim tim të plotë për t'i përballuar me dinjitet dhe me një nivel sa më të lartë profesional sfidat e zhvillimit. Dëshiroj ta mbyll paraqitjen time, duke falënderuar kryetaren e Komisionit për Politikën e Jashtme, zonjën Mimi Kodheli, dhe anëtarët e respektuar të këtij komisionit, si dhe duke shpresuar në ndihmën e tyre gjatë punës sime, në rast se zgjedhja ime do të konfirmohet! Përfitoj nga rasti për të falënderuar qeverinë, në mënyrë të veçantë ministrin Punëve të Jashtme, zotin Ditmir Bushati, që më ka propozuar në këtë post të rëndësishëm, post që shpresoj të mbështetet nga ky komision dhe më pas të konkretizohet me dekretimin nga ana e Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Kule!

Përpara se t'ua jap fjalën atyre që duan t'i bëjnë pyetje zotit Kule lidhur me pozicionin që i propozohet, shpresoj në një shfrytëzim më të mirë të kohës të kandidatëve të tjerë në prezencën e punës së tyre të ardhshme. E di që duhen nxjerrë të gjitha problematikat, e di që gjithçka është e nevojshme për t'u thënë, por brenda mundësive të jemi më racionalë me kohën.

Kush ka pyetje? Në qoftë se ka pyetje për vende specifike, në rregull, në qoftë se ka pyetje për të katër... Nuk e di, është diçka që nuk është praktikuar ndonjëherë, sepse pyeti zonja për marrëdhëniet specifike që Shqipëria ka me atë vend, që do të përfaqësohet nga një nga zotërinjtë.

Kështu që, a keni pyetje?

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull, pyetjet i bëjmë një nga një, në mënyrë specifike, për çdo përfaqësues dhe më pas jeni të lirë të bëni dhe diskutimin tuaj.

Pyetje për zotin Kule.

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati - Faleminderit, zonja kryetare!

Personalisht, më vjen mirë dhe mendoj se do të përfaqësohemi nga një njeri dinjitoz, aq më tepër që kemi të bëjmë me vende shumë mike dhe me një potencial bashkëpunimi ekonomik gjithmonë e në rritje dhe këtu doja të fokusoheshim. Shikojmë se Shqipëria po kthehet në një atraksion turistik, sidomos për vendet nordike si: Suedia, Finlanda, Norvegjia

dhe gjithmonë edhe më shumë do të shtohet numri i tyre. Çfarë mendoni se mund të bëjmë ne më shumë në këtë drejtim, duke qenë më pranë këtyre vendeve, sepse janë vende, që e vlerësojnë klimën tonë, kulturën tonë dhe të gjithë vlerat tona etnografike, prandaj dhe janë vende me të ardhura larta ekonomike, gjithmonë e më shumë kërkojmë që t'i kemi pranë Shqipërisë?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Urdhëroni, zoti Kule!

Virgil Kule – Në fakt, bazat e nisjes janë shumë të mira, flas për momentin që unë presupozohet se do të marr një detyrë përkatëse atje, sepse tashmë ne shikojmë se ka një fluks, ka një opinion të shtuar, kështu që nuk do të fillohet puna nga zero. Megjithatë, për sa i takon promovimit të vendit, të kushteve, të flukseve, të të veçantave të turizmit në Shqipëri, mbetet gjithmonë një punë shumë e madhe për t'u bërë. Mendoj se mund të përmblihet në një koncept, propagandë e shtuar në mënyrë të vazhdueshme, sa më kapilare, në bashkëpunim me organet shtetërore, sidomos në bashkëpunim me sektorë të ndryshëm të shoqërisë atje, siç është shtypi, siç janë agjencitë e mëdha turistike. Pra, si të thuash bashkëpunim dhe gjetje të kontakteve të njerëzve që e nxisin këtë punë, me njerëzit që kanë në dorë dhe që janë vendimmarrës në këtë drejtim. Po kështu edhe raporte për histori të suksesshme nga Shqipëria, të cilat duhet të gjejnë vend në faqet e shtypit suedez, por edhe në kanalet e tjera të saj. Mendoj se është krejt e pamjaftueshme puna propagandistike, ajo duhet të rritet në mënyrë të jashtëzakonshme.

Për sa i përket pyetjes se çfarë mund të bëhet në Shqipëri, mua më duket se jemi në një fazë, ku është premtuar shumë për një turizëm të madh. Unë pardje erdha nga Vlora, njerëzit e hoteleve thonë: “Ku janë turistët, se nuk po i shikojmë”. Domethënë, duhet të përputhen ato shifrat dhe propaganda e zyrtarëve me realitetin. Mendoj se është koha për të bërë takime me grupe interesi, që janë hotelieritë, në mënyrë që atyre të mos u fashitet shpresa, flas për atë që nuk i kanë hotelet plot akoma, në një kohë që disa të tjerë thotë se hotelet janë të mbushura, nuk ka vende e të tjera. Pra, duhet të jemi të përmbajtur, të singertë dhe konstruktivë në gjithçka që bëhet. Gjithçka e mirë duket me sy. Mjafton të dalësh sot në Tiranë dhe mund të shikosh sa shumë grupe turistësh ka. Di që ende nuk ka filluar në zona shumë të rëndësishme, për shembull, siç është Vlora, që unë e frekuentoj shpesh.

Tritan Shehu - Të them të drejtën mora spunto nga ajo që zoti Kule tha, sepse përgjigjen nuk e dha, se çfarë mund të bëjë një ambasador atje. Zoti Kule, ju pse e gjeni veten në diplomaci? Çfarë ju lidh me diplomacinë? Çfarë *background*-i keni ju në punën tuaj, ku

absolutisht gjithsecili respekton zgjedhjet, nuk kam asgjë, përkundrazi. Çfarë backgroundi keni që mund t'ju bëjë që menjëherë të kaloni pa qenë fare pjesë e trupit diplomatik në pozicionin kaq të lartë të ambasadorit në Shqipëri? Pse ky afrimetet i menjëhershëm për postin e ambasadorit, pa kaluar në shkallët e karrierës diplomatike të një vendi, siç zakonisht veprohet në çdo vend demokratik?

Virgjil Kule - Në ecurinë e karrierës sime asnjëherë nuk kam menduar për poste specifike të caktuara, nuk kam bërë plane, por kam ndjekur rrjedhat e jetës, duke u përpjekur gjithmonë që aty ku kam punuar, të punoj me një përkushtim, devocion maksimal dhe me nivele sa më të larta dhe të përditësuara të kohës. Dihet se gjatë punës sime në RTSH, ku kam qenë edhe Drejtor i saj, jam marrë me problemet ndërkombëtare, pra jam familjarizuar me çështjet ndërkombëtare, kjo nuk do të thotë se janë të ngjashme si atëherë edhe sot. Përveç kësaj në momentet kur u shkëputa nga kjo punë pata një karrierë shumë të gjatë në një organizatë ndërkombëtare që quhet “ Mjekët pa kufi”, ku pasi bëra një kurs të posaçëm u emërova në postin normal të numrit 2 të misionëve në disa vendeve të botës. Për një periudhë 10-vjeçare kam shërbyer për këtë organizatë në rolin e pjesës administrative dhe të proceseve të ngritjes së fondeve, organizata është holandeze. Unë kam qenë numri 2 i disa misionëve në Kaukaz, Moskë. Përveç këtyre kam pasur edhe misione të përkohshme në Azinë Qendrore si: në Taxhikistan, në Uzbekistan, në Mongoli dhe deri në Ukrainë, për një rast specifik edhe në Gjermani.

Nga ana tjetër jam një studiues i apasionuar i historisë, i gjeografisë, i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe atyre në përgjithësi. Nuk kanë qenë vetëm pasioni im, por jam rritur, jam ushqyer me këto, u kam dhënë jetë gjërave, i kam provuar në situata të ndryshme si ato të marrëdhënieve diplomatike në kuadër të një organizate siç ju thashë, qoftë edhe të marrëdhënieve të komunikimit.

Ju e keni CV-në time, zotëroj në nivel shumë të mirë disa gjuhë të huaja. Kam një përvojë shumë të madhe në komunikimin ndërkulturor për aq elemente diplomacie sa kanë organizatat ndërkombëtare. Mendoj se karriera ime 10 -vjeçare me një organizatë shumë prestigjioze ndërkombëtare përbën një aset dhe vlerë. Jam i bindur se do të vlerësohet shumë edhe nga partnerët suedezë.

Mimi Kodheli – Ju falënderoj!

Ishit më shumë sesa shterues me përgjigjet.

Falënderoj edhe kolegët!

Vazhdojmë dëgjesën me kandidatin tjetër për ambasador zotin Riza Poda.

Fjala është për ju.

Riza Poda - E nderuar zonja kryetare,

Të nderuara zonja dhe zotërinj anëtarë të komisionit,

Jam i nderuar që ndodhem sot para jush në cilësinë e kandidatit për ambasador të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kroacisë.

Dëshiroj të paraqes një tablo të përmbledhur lidhur me situatën aktuale të marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë, si edhe objektivat për të cilat angazhohem të punoj me të gjitha forcat së bashku me stafin, ekipin e ambasadës kurdoherë duke kërkuar ndihmën e këtij komisioni, në rast se do më konfirmoni ju dhe Presidenti i Republikës.

Do të dëgjoj me shumë vëmendje vërejtjet dhe sugjerimet tuaja si sot edhe në vijimësi për t'i mbajtur parasysht në të ardhmen, sikurse shpresoj dhe jam i bindur në mbështetjen tuaj.

Dua të nënvizoj se si programi i qeverisë ashtu edhe mbarë politika shqiptare kërkojnë që shërbimi ynë diplomatik të jetë sa më efikas në përfaqësimin e axhendës europiane të Shqipërisë, sidomos sot në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, të luajnë një rol kryesor duke qenë akoma më shumë aktivë në kërkim të vendimmarrjes europiane.

Nga ana tjetër, kërkohet që diplomacia të vihet në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit, duke ndërmarrë një kurs iniciativash një fushën e prokurimit në Shqipëri, pranë investitorëve të huaj dhe mbështetjes së biznesit vendës.

Kroacia. Marrëdhëniet ndërmjet Kroacisë dhe Shqipërisë vlerësohen në nivel shumë të mirë, të qëndrueshëm, pa çështje të hapura dhe me ecuri pozitive ndër vite. Zhvillohet një dialog politik intensiv, si në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe ashtu edhe në lidhje me situatën në rajon e më gjerë.

Kroacia është një bashkëpunëtoare e afërt në procesin e integritetit të vendit tonë, ka mbështetur plotësisht procesin e zgjerimit dhe të përfshirjes së të gjitha vendeve të rajonit në BE, ka mbështetur pa rezervë, ka ndërmarrë iniciativa dhe ka lobuar fuqishëm për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Kroacia është një aleate e rëndësishme për Shqipërinë në rajon, qëndrimet e saj, pozicionet në lidhje me çështjet rajonale e më gjerë, janë përgjithësisht në të njëjtën linjë me atë të Republikës së Shqipërisë.

Kroacia ka qenë një bashkudhëtare në procesin e anëtarësimit në NATO, dhe midis dy vendeve zhvillohet një bashkëpunim i ngushtë në kuadër të reformave në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare.

Sa më sipër, vlerësohet me siguri se Kroacia do të mbetet plotësisht e angazhuar në mbështetje të Shqipërisë deri në anëtarësimin e saj të plotë në BE.

Viti 2017, pra viti i kaluar, shënoi edhe 25-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve. Gjatë vitit u arrit që vendet t'i përcaktojnë marrëdhëniet si partneritet strategjik, gjë e cila u arrit gjatë vizitës së ministrit të Punëve të Jashtme në Zagreb. Dialogu politikë është zhvilluar normalisht, duke qenë më i prekshëm sidomos në çështjet rajonale.

Në aspektin ekonomik, duke gjykuar mbi bazën e potencialeve të të dyja vendeve, me rëndësi mbeten dy projekte strategjike rajonale: Korridori Blu dhe Gazsjellësi IAP.

Volumi tregtar në vitin 2017 arriti në 40 milionë euro, nga të cilat 6 milionë euro janë eksportet tona, ndërsa 34 milionë euro janë importet. Investimet direkte kapin vlerën e 14, 5 milionë eurove. Aktualisht, në Shqipëri operojnë 49 biznese kroate. Siç duket edhe nga shifrat e raportuara, ato janë në nivele të ulëta dhe larg potencialeve që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve. Sa më sipër, mbetet prioritet absolut dhe kryesor gjatë ushtrimit të detyrës sime.

Mes dy vendeve ka një kuadër ligjor favorizues, i cili nxit bashkëpunimin ekonomik, tregtar, si dhe investimet e ndërsjella.

Nga të gjitha analizat që bëhen, konstatohet se interesi i Kroacisë për bashkëpunim me Shqipërinë është kryesisht në fushën e energjisë, infrastrukturës, sektorit ushtarak, ekonomik, bujqësisë, segmenteve shkencorë e profesionalë, turizmit, si dhe në fushën e ekologjisë, duke synuar parandalimin e ndotjes së bregdetit.

Nga ana tjetër Shqipëria është e interesuar po ashtu për bashkëpunimin me Kroacinë në fushën e turizmit, energjisë, në transferimin e njohurive në fushën e legjislacionit, të investimeve dhe të integritimit evropian.

Kroacia është një nga shtetet më të rëndësishme në rajonin e Ballkanit. Shqipëria dhe Kroacia janë pjesë e disa projekteve strategjike për rajonin, si për shembull Korridori Adriatiko – Jonian, i ashtuquajtur edhe Korridori Blu, dhe Gazsjellësi IAP.

Çmohet se vendet tona ndajnë të njëjtin vizion për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian, përpjekjet e përbashkëta për të nxitur, përmes shkëmbimeve të shumëfishta dhe lidhjeve ekonomike dhe kulturore dhe lidhjt në mbarë Rajonin kanë vendosur baza të shëndosha në marrëdhëniet shqiptaro-kroate. Në këtë kuadër palët janë

angazhuar duke i dhënë përparësi institucionalizimit të partneritetit strategjik, i cili, ndër të tjera sanksionon bashkëpunimin e ngushtë politik e sektorial, partneritetin në NATO dhe angazhimin tonë konstruktiv në lidhje me sigurinë dhe perspektivën euroatlantike të rajonit.

Mimi Kodheli: Zoti Poda ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres. Për arsye të një mbledhje të rëndësishme që dy nga anëtarët e komisionit kanë ju lutem që të rezervoni të drejtën tuaj të shprehjes në momentin e pyetjeve në mënyrë që tu lemë kohë edhe kolegeve tuaj të shprehen.

Rezart Bregu – E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar deputetë të Komisionit të Jashtëm, anëtarë të Komisionit të Jashtëm.

(Diskutime pa mikrofon)

Rezart Bregu – Kam filluar për marrëdhëniet Shqipëri-Brazil për të evidentuar dhe për të nxitur. Përveç fjalëve që thashë më parë, mendoj se qeveria shqiptare është e angazhuar për një zhvillim intensiv të marrëdhënieve me Republikën Federative të Brazilit. Marrëdhëniet me Brazilin konsiderohen të mira dhe hapja e ambasadave në Brazil dhe në Tiranë ka ndihmuar në forcimin e tyre që nga viti 2009. Brazili është i vetmi vend amerikan - jugor në Shqipëri që ka ambasadë dhe jemi në situatën kur kemi vetëm një ambasadë për të gjithë rajonin e madh të Amerikës Latine që ndodhet në Amerikën e Jugut.

Për sa i përket aspektit politik, pas 90-ës tre ministra të punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë kanë vizituar zyrtarisht Brazilin, gjë që e ka ndihmuar dialogun politik dhe një njohje më të mirë të zhvillimeve tona demokratike. Do të punohet për realizimin e vizitave dhe takimeve të nivelit të lartë edhe në Shqipëri të autoriteteve braziliane, gjë që nuk ka ndodhur më parë.

Bashkëpunimi parlamentar, nmenjë nga parlamentet më të mëdha të botës, do të synojë konsolidimin e grupeve parlamentare të miqësisë dhe marrëveshjeve parlamentare.

Zgjedhjet e përgjithshme të tetorit të vitit 2018 në Brazil do ta konsolidojnë qeverinë e ardhshme braziliane, rrjedhimisht, politikën e jashtme dhe bashkëpunimin me vendin tonë.

Një pikë tjetër që kam veçuar është se Brazili nuk e ka njohur Kosovën. Qeveria braziliane ka riafirmuar zyrtarisht se nuk është kundër pavarësisë së Kosovës, por mbështet rezolutën nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit. Ne do të vazhdojmë ta inkurajojmë Brazilin që të rishohë qëndrimin e tij ndaj pavarësisë së Kosovës. Aspirata e Brazilit si anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurimit nëpërmjet reformës së OKB-së, e bën atë t'i përmbahet linjës së multilateralitetit, por, nga ana tjetër, Brazili ka njohur pasaportat apo dokumentet kosovare të udhëtimit.

Pikë tjetër.

Ekonomia më e madhe e Amerikës Latine dhe e nënta në botë, ka një bilanc tregtar shumë pozitiv me Shqipërinë. Në vitin 2017 nga rreth 46 milionë dollarë, që është bilanci ynë, 45 u përkasin eksporteve braziliane. Kjo flet qartë se çfarë potencialesh të mëdha ka në të vërtetë ky bashkëpunim për praninë e investimeve braziliane në një atmosferë të favorshme politike dhe ekonomike në Shqipëri. Nga ana e saj, pala braziliane e sheh sektorin bujqësor si një rrugë për të shtuar lidhjet tregtare me Shqipërinë dhe Ballkanin. Rajoni ynë është ndër zonat ku politika e jashtme ekonomike e Brazilit synon të shtojë praninë e tij.

Një aspekt tjetër që kam veçuar në këtë rezymë është se bashkëpunimi turistik, kulturor, shkencor, akademik dhe mbrojtja e mjedisit janë fusha të filluara edhe më parë, por që duhet të shoqërohen edhe me marrëveshje e aktivitete konkrete. Do të bashkëpunohet edhe me ambasadën e Brazilit në Tiranë.

Po i veçoj si prioritet të përmbledhura.

Konsullatat tona të nderit që kemi në Brazil dhe dhomat e tregtisë Brazil-Shqipëri në Recife dhe Rio de Janeiro janë një mbështetje e mirë për realizimin e aktiviteteve të ndryshme për forcimin e imazhit të Shqipërisë dhe organizimin e forumeve të biznesit apo kontakteve “*be to be*”.

Në fund, doja t’ju thosha që, duke ju falënderuar për vëmendjen, mbetem i hapur ndaj të gjitha vërejtjeve dhe këshillave tuaja të vlefshme.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Ju faleminderit, zoti Ambasador!

Zoti Kuka, fjala është për ju.

Ilirian Kuka - E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, anëtarë të këtij komisioni,

Ju falënderoj dhe ndihem i privilegjuar që po paraqitem para këtij komisioni në cilësinë e kandidatit për ambasador të Republikës së Shqipërisë në Republikën çeke!

Meqë duhet ta shkurtoj, po kaloj direkt në çështjet më thelbësore tek të cilat mendoj se duhet të fokusohem për 4 vjetëve e ardhshme. Siç e dimë, marrëdhëniet me Republikën çeke janë në një nivel të shkëlqyer bashkëpunimi në të gjitha fushat, si: industri, bujqësi, transport, arsim, shkencë, kulturë, mbrojtje dhe drejtësi. Vitet e fundit ka pasur një rritje të ndjeshme të këtyre marrëdhënieve dhe sidomos që nga viti 2015, kur pika kulminante u arrit me vizitën e Kryeministrit të Shqipërisë në Republikën çeke. Në këtë vizitë Kryeministri ishte i shoqëruar me një përfaqësi të madhe të biznesit shqiptar dhe gjatë asaj vizite u firmosën disa marrëveshje në nivel shtetëror dhe në nivel biznesi.

Pavarësisht këtij shkëmbimi të mrekullueshëm që kemi me Republikën çeke, do të përpiqemi t'i rrisim më tej këto marrëdhënie, duke u fokusuar plotësisht në:

Rritjen e vizitave dypalëshe në rang qeveritar, parlamentar dhe biznesit: si dhe në rritjen e investimeve, shkëmbimeve tregtare e kulturore. Për këto fusha ka hapësirë të gjerë sidomos në rritjen e eksporteve tona në drejtim të tregut çek. Rritja e përpjekjeve për të nxitur më tej praninë e investitorëve çekë në Shqipëri do të përbëjë një nga veçantitë e punës sime dhe të stafit të ambasadës. Në këtë drejtim, ka vend për bashkëpunim edhe me dhomat përkatëse të tregtisë, me agjencitë e biznesit midis dy vendeve, rritje dhe promovim të politikave dhe programeve të qeverisë, promovim të mundësisë strategjike, gjeografike dhe natyrore që ofron Shqipëria, duke marrë pjesë aktive në forume të ndryshme biznesi dhe investimesh.

Rritjen e bashkëpunimit në fushën e turizmit. Praktika e deritanishme ka treguar se turistët çekë vazhdojnë ta shikojnë Shqipërinë si një vend me resurse të mëdha, si dhe një ndër më të kërkuarit në rajon.

Rritjen e bashkëpunimit në fushën kulturore, duke synuar rritjen në nivel të bashkëpunimit, sidomos në drejtim të arsimit, shkencës, sportit, artit, kulturës, duke i parë ato si një ndër investimet më fitimprurëse për të ardhmen e vendin tonë.

Promovimi dhe ekspozimi i marrëveshjeve dypalëshe të nënshkruara për fusha ndryshme. Shumë prej këtyre marrëveshjeve zhvillojnë marrëdhënie konkrete, por ka edhe disa projekt marrëveshje të tjera, të cilat janë joefektive. Gjithashtu, ka edhe një numër të madh projekt marrëveshjesh, të cilat po diskutohen, por që ende nuk janë konfirmuar. Ky do të jetë një tjetër kapitull i rëndësishëm i veprimtarisë.

Të nderuar anëtarë të komisionit, duke shpresuar në vlerësimin tuaj pozitiv, angazhohem se do të jem i gatshëm dhe aktiv të bashkëpunoj me anëtarët e komisionit dhe anëtarë të tjerë të parlamentit, me synimin për të çuar para interesat e Republikës së Shqipërisë, si dhe forcimin e marrëdhënieve bilaterale me Republikën e Çekisë. Jam i hapur për pyetjet tuaja.

Faleminderit për kohën dhe vëmendjen!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Gjoshë.

Klajda Gjoshë – Faleminderit!

Falënderoj katër kandidatët që janë këtu për prezantimet e tyre. Në fakt, sot këtu kemi 4 figura të nderuara në pozicionet e tyre, dy prej tyre janë diplomatë në karrierë, të cilët i

vlerësoj shumë, edhe si kandidatura, për t'u emëruar tashmë si ambasadorë. Gjithashtu, edhe dy kandidaturat e tjera, siç e thashë, janë njerëz shumë të nderuar në karrierën dhe në punën që kanë pasur deri tani. Ndoshta unë do të kisha dashur që të shikoja njerëz që kanë më shumë eksperiencë në diplomaci, pra diplomatë karriere, meqenëse kemi të bëjmë me disa vende, të cilat janë anëtare të BE-së dhe që kanë marrëdhënie jashtëzakonisht shumë të rëndësishme me vendin tonë, aq më tepër që jemi edhe para diskutimeve për hapjen e negociatave vitin që vjen.

Unë dua t'iu them ambasadorëve që të përdorin të gjithë eksperiencën e tyre, karrierën e tyre, si dhe të gjitha mundësitë që do të kenë t'i vendosin në dispozicion të punës që duhet bërë për Shqipërinë, nëse do të ishte e mundur edhe për hapjen e negociatave në qershor të vitit 2019. Dua t'ju rikujtoj se Këshilli, në konkluzionet e tij, për herë të parë ka miratuar një kërkesë, të shkruar tashmë, për të marrë vendimin lidhur me negociatat, që ka të bëjë jo vetëm me kushtet që i janë vendosur Shqipërisë, por edhe me ratifikimin nga parlamentet anëtare. Pra, Këshilli u lë një opion të hapur të gjitha vendeve anëtare për të ratifikuar vendimin për negociata kombëtare në parlamentet e tyre dhe më pas ta shqyrtojnë në fund të qershorit. Prandaj, unë do të kërkoja një marrëdhënie të intensifikuar me parlamentin e Mbretërisë së Suedisë, me parlamentin e Kroacisë dhe të Çekisë bashkë me parlamentin shqiptar, sepse, nëse realisht do të kemi një punë konkrete me këto parlamente, unë e shikoj shumë të madhe mundësinë që Shqipërisë t'i hapen negociatat në qershor të vitit 2019. Besoj se, përtej punës që duhet të bëjë qeveria dhe të gjitha institucionet, ambasadorët kanë një detyrë realisht shumë të rëndësishme në këtë proces.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Gjoshë!

Ndaj të njëjtin mendim me ju, që marrëdhëniet ndërparlamentare midis vendeve anëtare të BE-së dhe parlamentin shqiptar janë të nevojshme sot më shumë se kurrë, që të mund të intensifikohen, duke dashur të përcjellim atë çfarë kemi arritur në 3 dekada demokraci: rritjen e një institucioni shumë të rëndësishëm, siç është Kuvendi i Shqipërisë, përgjatë gjithë demokracisë në këta vjet, duke dashur që të kemi një vend të veçantë, shumë të rëndësishëm, të cilin nuk e kemi arritur në parlamentet e tjera, ashtu siç ne do të kishim dashur që ta kishim. Kështu që ndaj të njëjtin opinion me ju dhe ju falënderoj që e thatë në këtë tryezë.

Para se t'i jap fjalën kolegut Shehu, kam dy pyetje shumë të shkurta për zotërinjtë që janë këtu prezentë.

Pyetjen e parë e kam për ambasadorin Bregu. Zoti Bregu, ju dëgjova drejt se në Brazil ne kemi vetëm dy zyra nderi. A mendoni se është e mjaftueshme, qoftë edhe për një vend të vogël si Shqipëria, që këto zyra të mund administrojnë një ndër rajonet më të rëndësishëm? Sepse për një vend, siç është Amerika Latine, me një ekonomi të madhe dhe me një popullsi të konsiderueshme, kjo patjetër që ndodh. Në gjykimin tuaj, a do të ishte e nevojshme dhe e domosdoshme që ne të rihapnim ambasadën tonë në Bones Aires apo në Amerikën Qendrore? Unë mendoj dhe besoj fort, në qoftë se ne do të kishim ambasadën tonë në Brazil, dhe ju të mos kishit në përgjegjësinë tuaj asnjë vend tjetër me të cilin kemi marrëdhënie, për përmasat dhe dimensionin që ka Brazili dhe çfarë ai përfaqëson për shkak të rëndësisë në ekonominë botërore, do të ishte më shumë se e mjaftueshme që të nxirrni një plan në 24 orë të ditës suaj. Kjo është pyetja: a mendoni se duhet të ketë më shumë se një ambasadë në Amerikën Latine?

Pyetja tjetër është për ambasadorin Poda, lidhur me marrëdhëniet e Shqipërisë me Kroacinë.

Shumë pak e dinë se Shqipëria ka lidhje shumë të vjetra me Kroacinë dhe që ka një diasporë që daton herët. Pak kush e di që shqiptarët e shekujve më parë kanë themeluar një nga qytetet më të preferuar turistik, atë të Zarës. Pra, lidhjet janë shumë të forta, janë historike dhe shumë të hershme. Zara është një krahinë, e cila tenton të ruajë akoma gjuhën e vjetër shqipe dhe kjo e bën lidhjen më të fortë, besoj për shkak të lidhjeve historike. Kroatët, edhe pse kanë atë infrastrukturë dhe atë bregdet, do të doja që të preferonin edhe bregdetin shqiptar për të kaluar pushimet, ndërkohë që shikojmë se shumë shqiptarë shkojnë dhe kalojnë pushimet atje.

Pyetja ime është: a do të ishit në gjendje, edhe pse ne e kemi një ministri të Diasporës, pavarësisht se në përmasa të reduktuara si një ministri pa portofol, të mund të rivitalizonit këtë marrëdhënie të kahershme të një miqësie që daton që në lashtësi, e cila nuk është një miqësi e krijuar në dy dekadat e fundit, për arsye të ngushta dhe të vogla gjeopolitike?

Ndërkohë që ndaj të njëjtin opinion me ju që Kroacia mbetet një ndër vendet dhe popujt më mik që Shqipëria dhe shqiptarët kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë dhe kjo është reciproke.

Këto ishin dy pyetjet. Fjala është për zotin Bregu.

Rezar Bregu – Faleminderit!

Unë kam një eksperiencë jo të vogël në Amerikën Latine, kam punuar dy mandate, me nga 5 vjet, me mbulim të gjithë rajonit të Amerikës Jugore, gjithashtu, kam qenë i

akredituar edhe në katër vende të tjera përveç Argjentinës. Këto vende kanë hapësira jo vetëm në konceptin gjeografik, por kanë hapësira me zhvillime gjeopolitike, me mundësi ekonomike dhe kulturore të jashtëzakonshme. Në Buenos Aires kemi pasur një ambasadë, duke pasur parasysh historikun rreth 40 vjet më parë, ku kemi pasur edhe një diasporë, të cilën e kemi tani, pavarësisht se është e brezit të tretë apo më shumë. Gjithmonë kemi kërkuar që të kishim një mbulim më të madh se sa Buenos Aires, gjë që e arritëm në Brazil, por për rrethana të kohës u mendua që të kishim vetëm një ambasadë, siç ka ndodhur me rimodelimet edhe në vende të tjera të botës dhe përgjithësisht në destinacionet e largëta.

Për mua është një sfidë shumë e madhe të punosh në Brazil, i cili është një nga qendrat më të populluara siç është Rio apo San Paolo, të cilat kanë me mijëra kilometra katrorë, ku çdo komunikim është vetëm nëpërmjet linjave ajrore dhe çdo kontakt me botën tjetër është në distanca të konsiderueshme.

Jam shumë dakord dhe do të luftoj fort që të ketë jo vetëm një përfaqësi tjetër, por që të kemi edhe staf më të madh, në mënyrë që të kemi efikasitet në punën tonë. Nuk mjafton të jesh i përfaqësuar në një vend, unë i kam provuar këto rrethana, sepse ndodhesh larg, por kërkon vëmendje duke shtuar praninë tonë me një ambasadë tjetër dhe me staf. Nuk mund të arrijmë dot të kemi një përfaqësim dinjitoz po nuk u bë kjo gjë. Ky është fillimi

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Riza Poda – Faleminderit, zonja kryetare!

Jam plotësisht dakord me atë çfarë thatë për Republikën e Kroacisë. Sipas informacionit që kam marrë, në Republikën e Kroacisë jeton një komunitet i madh me 40 mijë shqiptarë, të cilët janë shumë mirë të integruar dhe të organizuar, madje kemi edhe një përfaqësuese në Parlamentin e Kroacisë, një zonjë me origjinë shqiptare.

Për sa i përket bashkëpunimit në fushën e turizmit, është e vërtetë që Kroacia ka një bregdet të shkëlqyer, por unë mendoj se mund të kemi sukses duke rivitalizuar këtë lloj bashkëpunimi për turizmin, duke e lidhur me historinë, me kulturën, me një turizëm alternativ, duke bërë propagandë, duke bërë promovim përmes ministrive respektive, përmes agjencive të turizmit, operatorëve për të tërhequr turizmin kroat në Shqipëri. Unë jam i bindur se do të kemi sukses, megjithëse është e vështirë për shkak të arsyeve që dhatë edhe ju.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Zoti Shehu.

Tritan Shehu - Faleminderit!

Unë kam një pyetje për zotin Kuka. Në lidhje me materialin që unë pashë, zoti Kuka ka qenë në ambasadën shqiptare në Çeki në nga viti 2010-2014. Pas vitit 2014, do të doja të dija çfarë aktiviteti keni pasur?

Së dyti, në periudhën 2010-2014 më rezulton se keni qenë kryetar i bordit drejtues në “Mobile”, Kosovë, edhe këshilltar në ambasadën në Çeki. Si është kjo çështje?

Ilirian Kuka – Do të doja të saktësoja se në materialet dhe CV- në që kam sjellë, në ambasadë kam qenë këshilltar i jashtëm nga viti 2014-2018.

Tritan Shehu – Po këtu janë vite të tjera.

Ilirian Kuka – Është gabim. Ju kërkoj ndjesë kam qenë këshilltar i jashtëm, kam ofruar ndihmën dhe suportin tim për çështjet ekonomike.

Tritan Shehu – Në këtë sallë kemi 4 kandidatë për ambasadorë. Unë nuk kam asgjë personale, i falënderoj për kontributin e tyre, në punën që kanë bërë, për shembull, zoti Kuka më rezulton se është një biznesmen shumë i suksesshëm edhe në fusha të tjera.

Zonja kryetare, unë personalisht, si ish- ministër i Jashtëm, mendoj se në diplomaci ka një radhë karriere. Aspirata e çdo njeriu që i hyn diplomacisë është që të bëhet ambasador. Në momentin që dikush ka tërë jetën e tij në ndihmë të diplomacisë dhe pastaj shikon që në radhët atje lart vjen dikush që nuk ka pasur lidhje me diplomacinë, kjo për mua është handikap i madh dhe jo vetëm që handikapon në sistemin e diplomacisë, por mendoj se edhe i pezmaton diplomatët shqiptarë. Këtu kemi dy diplomatë karriere, që kanë qenë ambasadorë, është krejt normale karriera e tyre, nuk kanë pasur probleme në punën e tyre, kanë qenë seriozë, cilido që të ketë qenë kryeministër. Është krejt normale që të shkojnë në një vend tjetër në nivel ambasadori. Për mua nuk është normale që kolegë të tjerë, të nderuar në punët e tyre, janë caktuar në nivel ambasadori. Për mua ka diçka që nuk funksionon dhe pa dyshim pastaj të bën të hezitosh.

Po ta shohësh këtë edhe me ligjin që është, nuk është se ligji nuk e parashikon këtë gjë. Pra, ligji e thotë qartësisht se mund të zgjidhet edhe një njeri që nuk ka karrierë të plotë diplomatike me gradë të lartë, por ka kritere, të plotësojnë kushtet, pra në nenin 35, që për mua i plotësojnë, dhe duhet të ketë të paktën 10 vjet në politikën e jashtme, marrëdhëniet ndërkombëtare, marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, ndër të cilat 3 vjet në pozicione drejtuese.

Pra, nuk është se ligji nuk e ka, të paktën 3 vjet rol drejtues në diplomaci.

Pra, sidoqoftë unë personalisht mendoj se duhet t'i rekomandojmë Ministrisë së Jashtme që të jetë shumë e kujdesshme dhe të bazohet tek trupa diplomatike shqiptare. Ne

nuk jemi trupa diplomatike shqiptare e viteve '92-'93, të jemi të sinqertë, tashmë kemi një trup diplomatik shqiptar me 20 vjet eksperiencë pune e kontributesh të mëdha. Unë mendoj se duhet të bazohemi tek ata, jo sepse .. *(nuk kuptohet)*, por përkundrazi, kjo që bëhet, është diskriminim për trupën diplomatike shqiptare.

Ndaj, zoti zëvendësministër, unë mendoj ta forcojmë...*(nuk kuptohet)*, e cila duhet të bazohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...sepse, realisht, trupa diplomatike shqiptare duhet të jenë ambasadorët e ardhshëm, të cilët do të filtrohen në shumicën dërrmuese të vendeve. Përfjashtimet janë shumë të rralla kudo në botë, ju e dini shumë mirë. Shikoni vendet e BE-së, dikush që ka qenë ministër i Jashtëm, apo kryetar i Komisionit të Jashtëm, pra përfjashtimet janë shumë të vogla.

Zoti Strajkoviç, ju lutem shumë, kthimi në histori, mendoj të rekomandoj... se do të ishte ndryshe pastaj, lindin dyshime të mëdha në betejën e përzgjedhjes, në mënyrën e përcaktimit të afrimiteteve politike, të afrimiteteve të tjera, të cilat janë shumë të largëta për diplomacinë e një vendi siç është Shqipëria. Ky është një moment që duhet marrë me shumë seriozitet.

Këto kisha si objeksione. Në qoftë se zotërinjtë e nderuar, që janë këtu, do t'i kalojnë këto prova dhe do të zgjidhen si ambasadorë, u uroj suksese në funksionet e tyre, ashtu siç u afrojmë edhe bashkëpunim të plotë në fushën ku ata do të shërbejnë. Këto vërejtje i kam për Ministrinë e Jashtme, qeverinë shqiptare dhe, në mënyrë indirekte, ia përcjell edhe Presidentit të Republikës.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, kolegu Shehu!

Në fakt, edhe unë ndaj disa mendime të njëjta me ju.

Kjo tregon që Komisioni i Politikës së Jashtme është në nivelin që duhet të jetë.

Fjala për zotin Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Bashkë me kolegen Ferhati kemi kënaqësinë dhe nderin të përfaqësojmë Shqipërinë në Këshillin e Europës. Më vjen shumë mirë që nga të gjitha takimet bilaterale që kemi pasur edhe në Kroaci dhe në Çeki, kemi kuptuar mbështetjen që do të na japin.

Dua të falënderoj ambasadorin Poda për nivelin e lartë të komunikimit, si me Kryetarin e Parlamentit dhe Kryetarin e Senatit në Çeki, ku ka lobuar fort për Shqipërinë. Ato janë vende, të cilat na kanë mbështetur dhe do të vazhdojnë të na mbështesin në integrimin

tonë në Europë, por gjithashtu, me këto vende kemi edhe marrëdhënie shumë të mira ekonomike. Shpresoj që kjo të vazhdojë si traditë e mirë dhe të kalojmë në një nivel tjetër. Aq më tepër, sot me Çekinë kemi një nivel të lartë turistik, të cilin e shikoj si vlerë të shtuar, që një person me background ekonomik dhe biznesi, përpiqet ta përafrojë sa më shumë rrugën e turizmit të Shqipërisë me Çekinë.

Konkurrencën në turizëm me Kroacinë nuk e shikoj si sfidë, por si një paketë të unifikuar të shumë turistëve që vijnë nga vende jashtë kësaj zone të Mesdheut. Kjo paketë udhëtimi nga Kroacia te Mali i Zi, te Shqipëria duhet parë si vlerë e shtuar. Po shohim atë që po ndodh në zonën mes Shqipërisë – Malit të Zi dhe Kosovës, ku turi i Alpeve shqiptare është integruar tashmë. Sot turistët kërkojnë të shohin sa më shumë brenda një kohe të shkurtër dhe ku ka më bukur sesa të ketë një paketë turistike mes Kroacisë-Malit të Zi dhe Shqipërisë, tri rajone kaq të ngjashme, njëkohësisht edhe të ndryshme. Kjo do të na përafrojë me vendet e tjera dhe do të përmirësojë pozitën konkurruese të Shqipërisë. Ne mund të mësojmë shumë nga Kroacia, një vend që ka ecur kaq shumë përpara, duke mos e parë si sfidë, por si një mënyrë rritjeje.

Gjithashtu, më vjen mirë të them që kemi shumë potencial për të zhvilluar turizmin, parë kjo edhe nga eksperiencia e vizitës disaditore që patëm në Çeki, ku ishte pjesëmarrës edhe zoti Panariti. Zoti Kuka na mundësoi një sërë takimesh të niveleve të larta. Shqipëria duhet ta shikojë Çekinë jo vetëm si një vend mik, por edhe si partner shumë potencial për turizmin në të ardhmen duke shpresuar të kemi sa më shumë vizitorë çekë, të cilët kanë qenë gjithmonë dashamirës të Shqipërisë dhe janë nga udhëtarët dhe turistët më të mëdhenj të Europës njëlloj si dallëndyshet shtegtuese, që, kur shkojnë në vende të tjera, tregojnë se çfarë shohin në Shqipëri.

Shpresoj që ky bashkëpunim të arrihet sa më shpejt.

Faleminderit!

Mimi Kodheli -Faleminderit!

Fjala për zotin Balliu.

Klevis Balliu – Sot më shumë se kurrë kemi nevojë të jashtëzakonshme për t'i parë me kujdes emërimet nëpër ambasada. Është një moment delikat për Shqipërinë duke pasur parasysh edhe procesin e integritetit të Shqipërisë në BE. Na duhet të presim, fatkeqësisht, edhe një vit tjetër për hapjen e negociatave. Kjo nuk ka ardhur për shkak të një përfaqësie të dobët nga ambasadat shqiptare, nuk besoj që ka qenë ky rasti, por për ambasadorët shqiptarë ka qenë shumë e vështirë që të përfaqësojnë Shqipërinë me dinjitet, për shkak të problemeve

që kishte qeveria, duke mbajtur mbi supe edhe akuzat dhe informacionet e instancave ndërkombëtare për lidhjet e qeverisë me krimin e organizuar, kanabisin e të tjera pa fund.

Kam një problem këtu, për shkak se përveç konsumit të kanabisit që është shumë i rëndë, një kostum tjetër që është shumë i rëndë për një ambasador shqiptar, është kostumi komunist, i cili fatkeqësisht këtu nuk po ndahet dot. Shoh këtu që zoti Kule, ka dhënë një sqarim pse ka dhënë dorëheqjen nga ky post, si drejtor i Televizionit Shqiptar, për shkak se nuk kishte pranuar porositë e Partisë së Punës së shqiptarëve. Unë këtë e marr pak si ofenduese, sepse të gjithë e dimë se çfarë ndodhte në diktaturë kur nuk zbatoheshin urdhrat e partisë dhe është e çuditshme që paska shkuar dhe aq mirë...

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, mos më ndërprisni se nuk janë çështje për ty këto!

Mimi Kodheli – Deputeti e ka me të dëgjuar se nuk e ka e ka jetuar atë kohë..

Klevis Balliu – Po, deputeti e ka me të dëgjuar, por shqyr Zotit që njerëzit shkruajnë dhe ka dokumente...

Zoti Kule, unë e di që ju keni qenë drejtor i TVSH-së dhe në 11 prill të 1985-s jeni po ju, se është edhe një video në *youtube*, por nuk dua ta nxjerr tani këtu, jepnit lajmin në mes të lotëve për vdekjen e Enver Hoxhës. Pra, unë mendoj se në Shqipëri ka plot njerëz të tjerë, të cilët mund të na përfaqësojnë denjësisht, që nuk kanë lidhje dhe nuk kanë qenë përfaqësues të niveleve të larta të diktaturës, madje jam i sigurt se ka edhe brenda Partisë Socialiste njerëz, intelektualë, akademikë, intelektualë, diplomatë që mund të na përfaqësojnë.

E shoh të paarsyeshme që medoemos një person që nuk ka edhe eksperiencën dhe biografia e tij për një vend demokratik nuk është tamam pozitive, të shkojë atje. Unë e kam një përgjigje pse. Në qoftë se kemi ministër të Jashtëm djalin e ish-sekretarit të parë të Partisë të Shkodrës, i cili ka plot 6 faqe këtu nga njerëz që i ka internuar vetë ai, atëherë, kjo më bën të kuptoj se emërime të tilla vijnë nga linja të vjetra të kësaj partie, e cila fatkeqësisht edhe sot nuk po ndahet nga këto linja.

Unë do t'i kërkoja Komisionit të Jashtëm, ministrit të Jashtëm, Presidentit dhe kujtdo që ka mundësi të bëjë diçka që ne të mos përfaqësohemi me njerëz të niveleve të larta komuniste të diktaturës komuniste në vendet e Europës dhe të botës, gjetjen e individëve të tjerë, të cilët me karrierë apo pa karrierë, nuk po u hyj këtyre detajeve, se ato ju i bëni publike nëse doni, të paktën të mos kenë lidhje me diktaturën dhe kjo është një kërkesë minimale, duke qenë se jemi edhe në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin European.

I humbëm negociatat për këtë vit, por shpresoj të mos t'i humbim edhe për vitin tjetër.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjalën e ka zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja kryetare!

Do të doja ta përgëzoja sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Jashtme, si dhe të gjithë zotërinjtë kandidatë për ambasadorë, për një punë të bërë mirë sa i takon faktit të kriterëve ligjore dhe procedurave të ndjekura, sepse besoj se kemi të bëjmë me emërimë dhe pozicione, të cilat nuk do ta tregojnë Shqipërinë vetëm në një vend të caktuar, por në kuadrin e një politike të gjerë të jashtme dhe në kuadrin e proceseve integruese të vendit dhe në kuadrin e intensitetit të marrëdhënieve tona jashtë BE-së me vende të tjera. Pra, është mjaft e rëndësishme të kemi një qasje tashmë të njësuar të të gjitha arritjeve që janë brenda vendit, të cilat duhen përkthyer në rezultate sipas interesave të vendeve ku ne dërgojmë përfaqësuesit tanë, në mënyrë që të kemi mbrapsht rezultate në shërbim të interesit publik.

Në fakt, nëse këtë lloj procedure apo këtë lloj emërimi e përziejme me populizma, them se i prishim punë procesit. Ky është një proces, i cili duhet të ecë vetëm në bazë të meritës dhe të integritetit të kandidatëve. Kur flasim për integritet dhe zotësi, kriteret janë të përcaktuara qartësisht në ligj, prandaj ne nuk kemi pse të aludojmë në mbledhje të këtilla se cilat janë qëllimet dhe biografite, sepse falë Zotit koha e biografive ka mbaruar dhe të gjitha gjërat që shihen sot i zgjedh qartësisht t'i zbatojë dhe t'i parashikojë ligji.

Pra, nëse i referohemi ligjit të posaçëm, i cili parashikon mënyrën se si përzgjidhen kandidatët për ambasadorë, cilat janë kriteret, ato janë shumë të qarta. Është një komision i posaçëm, i cili krijohet pranë Ministrisë së Jashtme me ekspertë të fushave dhe ata shohin të gjitha kriteret për sa i takon vjetërsisë dhe të gjitha kushtet që duhen të plotësojnë kandidatët para se ata të vijnë në dëgjuesë në komision. Është një kompetencë prerogative tashmë që ligji ia aderon qartësisht ministrisë në një komision që kryesohet nga sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme, procedurë që tashmë është ndjekur nga i gjithë dokumentacioni që ne kemi konsultuar dhe e shoh të plotësuar të gjitha kriteret e ligjit. 2 elemente janë ndaluese për sa u takon kandidatëve, të parashikuara në nenin 35, që kanë të bëjnë pikërisht me faktin që kandidatët të mos jenë pjesë e partive apo e organizatave politike dhe në të shkuarën të mos kenë qenë bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit. Nëse do të ishim para këtyre dy kushteve për kolegët e opozitës, jua them me bindje se këtu nuk do të ishim duke dëgjuar kandidatët.

Kështu që kjo fazë ka kaluar dhe unë jam e kënaqur si deputete, që kandidatët që dëgjova, jo vetëm në atë çfarë lexova për sa i takon karrierës së tyre individuale, por edhe në

atë që e paraqitën për veten e tyre, japin siguri për një përfaqësim dinjitoz të Republikës së Shqipërisë në vendet ku do të caktohen.

Unë e di që ju do të flisni me një gjuhë për sa i takon pjesës së politikës së jashtme, sipas orientimeve dhe vendimeve që do të marrë qeveria dhe Ministria e Jashtme në kuadrin e politikave me vendet ku jeni caktuar të shërbeni. Kjo do të jetë një çështje që, sigurisht, do të ndiqet edhe nga ky komision.

Ajo për të cilën unë jam shumë më e interesuar, në fakt, ka të bëjë me diplomacinë ekonomike, sepse mbaj mend që përpara më pak se një viti, bashkë me kryetaren e komisionit, kemi qenë në konferencën e organizuar me gjithë përfaqësuesit tanë jashtë, për intensifikimin e punës në drejtim të diplomacisë ekonomike.

Mendoj se do të kemi një raport se çfarë ka ndodhur që nga ajo konferencë e këtej, por unë pres, në fakt, që ju si ambasadorë, në vendet ku do të shkoni, ta keni të qartë dhe konkrete diplomacinë ekonomike, me objektiva të sakta, jo thjesht si një nga pikat e punës, por me objektiva të qarta dhe konkrete se çfarë do të vijë mbrapsht në Shqipëri nga e gjithë kjo punë juaja, sepse mendoj se diplomacia ekonomike arrin të bëjë më së miri edhe plotësimin e qëllimeve për diplomacinë në tërësi. Është një pjesë shumë e rëndësishme.

Kështu që nuk më mbetet gjë tjetër veçse t'ju uroj punë të mbarë!

Shpresoj t'i keni në konsideratë këto që themi këtu.

Në fakt, zonja kryetare, kam një përgëzim edhe për ju. Këto ditët e fundit është i vetmi komision, ku puna kryhet sipas rregullave dhe nuk ka polarizim të debateve politike, aq më tepër kur flasim për çështje kaq të rëndësishme të ditës, edhe në kuadër të proceseve integruese të vendit me jashtë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolege Bushka!

Kjo është...

Klevis Balliu – Zonja kryetare, kam një pyetje të shkurtër, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Ta mbaroj.

Kjo është falë jush, nuk ka të bëjë me mua. Sigurisht, ka të bëjë edhe me tematikën dhe llojin e komisionit. Ka disa elemente, që e bëjnë komisionin të jetë, jo më i miri, por pak më ndryshe.

Adnor Shameti – Ne nuk jemi më të mirët, por më të mirë nuk kemi parë...

Mimi Kodheli – Zonja Hoxha, më pas ka një pyetje zoti Balliu dhe në fund një shtesë të vogël Tritani për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Diskutime pa mikrofon)

Unë jam dakord. E ke ngacmuar apo...*(nuk dëgjohet)* në diçka dhe absolutisht që ish-ministri Shehu ka të drejtën e një komenti mbas ngacmimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

Zonja Hoxha fjala për ju.

(Diskutime pa mikrofon)

Elona Hoxha – Dëshiroj të falënderoj ambasadorët e propozuar, zotin Kule, zotin Poda, zotin Bregu dhe zotin Kuka, për prezantimin e tyre dinjitoz, sigurisht, edhe ministrin e Punëve të Jashtme dhe sekretarin e Përgjithshëm, si dhe ministrin që i ka propozuar, për këto kandidatura, të cilat kanë një mision të vështirë, por ndërkohë ndihmojnë në prezantimin sa më të mirë të Shqipërisë në vendet përkatëse!

Në fakt, kisha edhe një sugjerim për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Meqenëse ambasadorët vijnë në mënyrë periodike, të paktën, në dijeninë tonë, një herë në vit për mbledhje, të kemi mundësinë që edhe ne si komision (dhe këtë ia drejtoj edhe kryetares së komisionit) të njihemi me punën dhe progresin e bërë nga ambasadorët, pasi në përgjithësi ne i shikojmë ambasadorët në momentin kur ata prezantohen dhe pastaj mbas 4 vjetësh, nëse rinkonfirmohen, në disa raste të veçanta apo në pozicione të tjera ekuivalente, do të ishte mirë.

Ju prezantuat të gjitha aspiratat dhe sfidat që ju presin, kështu që është në nderin e Komisionit për Punët e Jashtme të diskutojë dhe dialogojë me ju.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolege Gjebrea!

Ka pyetje?

Fjalën e ka zoti Balliu dhe më pas ka një koment zoti Shehu.

Klevis Balliu - Dua të pyes diçka për ligjin, sepse nuk e di nëse është vërtetë ashtu siç u tha apo është lapsus.

Zonja Bushka përmendi bashkëpunëtorët e Sigurimit. Nëse je oficer Sigurimi, je në rregull për t'u bërë diplomat? Vetëm për bashkëpunëtorët ...? Bashkëpunëtor është ai që

bashkëpunon me oficerin e Sigurimit. Për oficerët e bashkëpunimit është në rregull të bëhesh ambasador, kurse për bashkëpunëtorët, jo? Ligji thotë: bashkëpunëtorët e Sigurimit.

Zonja Klotilda përmendi “bashkëpunëtorët e Sigurimit”. Po oficerët e Sigurimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Apo ata do t’i bëni deputetë? Na e sqaroni pak.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, është pyetje.

Thatë: “Sipas ligjit, bashkëpunëtorët e Sigurimit nuk lejohen të bëjnë karrierë”. Po oficerët e sigurimit lejohen?

Zonja Bushka, po ju bëj një pyetje? Po oficerët e Sigurimit lejohen?

Mimi Kodheli – Së pari, nuk është e nevojshme që pyetja të bëhet dhjetë herë që të kuptohet.

Së dyti, nuk jemi këtu për të debatuar me njëri-tjetrin, por në komision dëgjimor.

Ju pyetët zonjën Bushka, por nuk është në rendin e ditës ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Sheu, një koment për ambasadorin Poda.

Tritan Shehu - Pyetja ishte shumë delikate. Nëse ka ndonjë gjë konkrete ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Zoti Shehu, nuk bie në sy nëse e kalojmë pa debat këtë ditë komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tritan Shehu – Dëgjuam zotin Poda të bënte prezantimin ...

Ju përmendët Kroacinë si partner strategjik me Shqipërinë. Nëse po, më jepni të drejtë dhe më pas unë do të vazhdoj me komentin tim.

Riza Poda – Po negociohet për të realizuar një partneritet strategjik me Kroacinë. Madje është realizuar një deklaratë dhe pritët të nënshkruhet nga të dyja palët.

Tritan Shehu - Unë ju mirëkuptoj, zoti Poda.

Unë si nënkryetar i Komisionit të Jashtëm ju këshilloj që të mos mbushni thasë me partnerë strategjikë, sepse kështu po zhvlerësojmë partnerët e vërtetë strategjikë.

Zoti sekretar i Përgjithshëm, fatkeqësisht unë kam parë dhe kam debatuar në vijim për këtë gjë, ju si ministri po shtoni në mënyrë artificiale partnerë strategjikë, krijoni katërkëmbështa, fusni partnerë strategjikë të tjerë, që realisht dëmtojnë konceptin e partnerit strategjik. Partnerë tradicionalë ... kanë qenë vendet fqinje, anëtare të BE-së dhe NATO-s, që

na ndihmojnë dhe na shtyjnë përpara në procesin e integritit evropian. Prandaj, zgjerimi i mëtejshëm me partnerë strategjikë do të na çojë deri Suedi apo Lindje. Bashkëpunimet strategjike kanë disa rregulla. Nuk janë partneritete strategjike disa fletë lavdërimi që lëshon ministri i Jashtëm apo ministria. Për mua kjo është infantilizëm i Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, kolegu Shehu!

Unë mendoj që ne mund të thërrasim ministrin e Punëve të Jashtme për të na dhënë një pasqyrë më të detajuar për të gjithë programin afatgjatë të punës së ministrisë që ai drejton sot, por lidhur edhe me konsideratat që ka për çdo vend nëse për politikën tonë të jashtme është e nevojshme të quhen strategjike apo jo marrëdhëniet midis vendit tonë dhe vendeve për të cilat po flasim.

Ju falënderoj për seriozitetin!

Zoti Barbullushi, ju falënderoj për prezencën dhe ju uroj punë dhe ditë të mbarë!

Faleminderit, kolegë!

MBYLLET MBLEDHJA